



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.348/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj-kryesues, Kymete Kicaj dhe Hidajete Gashi Alaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Dëbora Sallauka, candidate për anëtare të kuvendit komunal në Komunën e Prizrenit, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të paraqitur kundër Qendrës Komunale të Numërimit (QKN), në Prizren, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 27.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHEN të pasafatshme ankesat ZL.Anr.348/2025 dhe ZL.Anr.349/2025, datë 25.10.2025, të parashtruara nga kandidatja për anëtare të kuvendit komunal në Komunën e Prizrenit, Dëbora Sallauka nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV) të paraqitur kundër Qendrës Komunale të Numërimit (QKN), në Prizren, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 25.10.2025, PZAP-i ka pranuar dy ankesa ZL.Anr.348/2025 dhe ZL.Anr.349/2025 të kandidatës për anëtare të kuvendit komunal në Prizren, Dëbora Sallauka, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV), në ankesën ZL.Anr.348/2025 parashtruesja e ankesës pretendon se për shkak të garës së ngushtë në procesin e numërimit ka zyrtar (numërues të votave) që kanë lidhje familjare (konflikt interesi) duke shtuar faktin se Shqipe Salihu është asambleiste aktuale e cila e bënë procesin jo transparent dhe ka konflikt interesi me monitoruesen Gentijanë Shatri . Tutje, parashtruesja e ankesës thekson se kërkon nga PZAP të shqyrtojë dhe të miratojë kërkesën për rinumërim të rezultateve të zgjedhjeve për vendvotimet 2024/01, 2024/02, 2024/03, 2024/04 dhe 2024/05 në mënyrë që çdo paqartësi të eliminohet dhe çdo dyshim për ndikim të jashtëm të qartësohet.

Parashtruesja e ankesës në ankesë ka bashkangjitur si dëshmitar një vëzhgues në QKN, që pretendon se e ka vërtetuar konfliktin e interesit dhe e ka njoftuar ankuesen me datë 24.10.2025 si dhe një deklaratë të saj që hedh të gjitha pretendimet e një listë të vëzhguesve.

Në ankesën ZL.Anr.349/2025 të kandidatës për anëtare të kuvendit komunal në Prizren, Dëbora Sallauka, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV), parashtruesja e ankesës pretendon se me datën 24.10.2025 Skender Tejeci e ka njoftuar se ka kuptuar që ka një mospërputhje mes gjendjes faktike dhe votave në sistem. Sipas parashtruesës së ankesës, 9 familjar e kanë votuar në Gorozhup (2026/01) por në sistem i dalin vetëm 5 vota dhe gjithashtu në fshatin Planej në vendvotimin 2064/01, ankuesja pretendon se e kanë votuar mirëpo në sistem paraqiten 0 vota.

Si prova, parashtruesja e ankesës ka bashkangjitur letërnjoftimet identifikuese të disa personave që sipas saj e kanë votuar.

Në përgjigjen në ankesë të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve – KQZ, sqaron se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), KQZ-ja përcakton me akte nënligjore, kriteret për numrin e grupeve të rinumërimit për çdo vend të numërimit të votave, mënyrën e organizimit të punës, ndarjen e detyrave mes anëtarëve të grupit të numërimit dhe rregullat për radhën e veprimeve. Grupet e numërimit emërohen nga KQZ-ja, në bazë të nominimeve të partive politike dhe duke ju dhënë përparësi anëtarëve të këshillave të votimit që kanë shërbyer në ditën e zgjedhjeve. Gjithashtu bazuar në nenin 20 të Rregulloren Zgjedhore Nr. 16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), përcaktohet mënyra e përzgjedhjes së ekipeve të numërimit. Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese lidhur me ankesën A.nr.349, e cila mbështetet në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave dhe familjarëve të saj duhet theksuar se në kuptim të nenit 4 par.1.3 të LZP-së, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit.

Në lidhje me pretendimet e palës ankuese në ankesën A.nr.348 dhe 349, pas analizimit të lëndës është vërejtur se pala ankuese ankesën e ka paraqitur jashtë afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sepse pas konfirmimit të ZEKKKZ në komunën e Prizrenit, aktiviteti i QKN-së është përmbyllur me datën 18.10.2025, në ora 22:10 ndërsa pala ankesën e ka parashtruar me datën 25.10.2025. Pra nuk është brenda afatit ashtu siç parashihet me nenin 105, par.1 të LZP. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesave është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkangjitur prova relevante që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e mospërputhjes së rezultateve zgjedhore.

Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallën nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevojë të veçantë; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LZP, pala mund të ushtrojë ankesë në afatin brenda

dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Gjithashtu, KQZ njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve-QNR dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar dy ankesat ZL.Anr.348/2025 dhe ZL.Anr.349/2025 të datës 25.10.2025, të paraqitura nga kandidatja për anëtare të kuvendit komunal në Komunën e Prizrenit Dëbora Sallauka, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), kundër Komisionit Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me numrat e ankesave si më lartë dhe të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohet nën shenjë të përbashkët ZL.Anr.348/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankueses.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës ka gjetur se:

- Ankesat janë të pasafatshme

Paneli, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se ankesat e parashtruara nga Dëbora Sallauka, kandidate për Kuvendin Komunal në Prizren nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, me të cilën ka pretenduar se ka pasur parregullsi në numërim të votave, është e parashtruar pas afatit të paraparë ligjor.

Dispozita e nenit 105.1 të Ligji Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcakton se *“Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”*. Ndërsa në nenin 9, paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se *“Personi mund të paraqesë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara gjatë procesit të administrimit dhe numërimit në QKN dhe QNR”*. Po ashtu në nenin 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parasheh që: *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”*.

Në rastin konkret Paneli vlerëson se parashtruesja e ankesave ka dorëzuar ankesat në PZAP me datë 25.10.2025, ku ka pretenduar për parregullsi të evidentuar gjatë procesit të numërimit të votave në QKN-Prizren, ndërsa nga të dhënat zyrtare, e po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ është vërtetuar se aktiviteti i QKN-së në Komunën e Prizrenit, është përmbyllur me datën 18.10.2025, me çka vërtetohet se ankesat e ankueses nuk janë paraqitur brenda afatit ligjor siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, andaj dhe të njëjtat u deshtë që të hedhen si e pasafatshme.

Paneli pas analizimit të shkresave të lëndë ka gjetur se ankesat janë parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 105, paragrafi 1 LZP-së, dhe nenit 9, paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, afati për dorëzimin e ankesës është brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, ndërsa ankesat janë dorëzuar në PZAP më datë 25.10.2025, ndërsa parregullsia për të cilin pretendon pala ankuese është bërë gjatë numërimit të QKN, i cili ka përfunduar më datë 18.10.2025, që do të thotë se ankesat janë dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Andaj, nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 105 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16 dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.348/2025, datë 27.10.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.